

**VENDIM**  
**Nr.871, datë 18.6.2008**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.31, DATË 20.1.2001 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE**  
**TETRAPLEGJIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Fjalía e parë e pikës 4 të vendimit nr.31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Masa e përfitimit për invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, është 8 700 (tetë mijë e shtatë qind) lekë në muaj dhe kjo masë indeksohet, çdo vit, me ritmet e rritjes së pagës minimale, në shkallë vendi, por masa e indeksuar e pagesës të mos jetë më shumë se masa e pensionit minimal në qytet, në shkallë vendi. Kjo pagesë përfitohet pavarësisht nga mosha dhe të ardhurat, që përfitojnë nga shteti. Të njëjtën pagesë përfiton edhe kujdestari i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, i caktuar në përputhje me pikën 1 të këtij vendimi.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën 1 700 000 (një milion e shtatëqind mijë) lekë, të përballohen nga fondet e buxhetit të vitit 2008, grupi 25, titulli 064, kapitulli I, artikulli 606, zëri “Transferta të familjeve dhe të individëve”, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Financave, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**